



“Çka ka për mua?”

Mundësitë e BE-së për arsim,
kulturë dhe rini



Bashkimi Evropian përkrahë një gamë të gjerë aktivitete në fushën e arsimit, trajnimeve, kulturës, hulumtimit dhe të rinisë. Kjo broshurë jep informata të shkurtra lidhur me disa prej programeve të udhëhequra nga Drejtoria e përgjithshme për arsim e kulturë. Për ta bërë konsultimin më të lehtë, në broshurë nuk përdoret gjithmonë terminologjia formale e BE-së dhe nuk përfshihen të gjitha programet, instrumentet dhe veprimet e BE-së. Megjithatë, në çdo pjesë të tij theksohet se ku mund të gjenden më shumë informata. Po ashtu, renditen edhe agjencitë vendore dhe organizatat e tjera të rëndësishme, përmes të cilave mund të bëhet pjesëmarrja në aktivitete.

Aty mund të ketë diçka edhe për ju.



Europe Direct është shërbim që ju ndihmon të gjeni përgjigje në pyetjet e juaja për Bashkimin Evropian.

Numri pa pagesë i këtij shërbimi është: (*) 00 800 6 7 8 9 10 11

(*) Disa operatorë të telefonisë mobile nuk lejojnë qasjen në numrat 800 apo këto telefonata mund edhe të faturohen.

Më shumë informata për Bashkimin Evropian mund t'i gjeni në faqen e internetit (<http://europa.eu>).

Katalogimi i të dhënave mund të gjendet në fund të këtij botimi.

Luksemburg: Zyra e botimeve e Bashkimit Evropian, 2010

ISBN 978-92-9238-049-6

© Bashkimi Evropian, 2012

Dizajni grafik nga Stefano Mattei

*Shtypur në Kosovë**

*Pa paragjykim për statusin e Kosovës, në përputhje me RKS KB 1244 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

A jeni mësimsdhënëës që dëshironi t'i zgjeroni njohuritë e nxënësve tuaj për një vend tjetër të BE-së?

Student që dëshironi që një semestër të e kaloni jashtë vendit?

Hulumtues i ri që analizoni mundësitë për karrierë?

Ndoshta ju udhëhiqni një grup rinor apo shoqatë të prindërve, ose keni përgjegjësi për trajnime në odë ekonomike, në shoqatë industriale apo në sindikata.

Mund të marrin pjesë madje edhe stacionet e radios të pranishme në internet apo botuesit që dëshirojnë të përkthejnë një roman të ri.

Koreograf që dëshironi të zhvilloni një projekt mbarë evropian të vallëzimit?

Distributor që dëshironi të promovoni filma evropian?

Autoritet vendor i arsimit, i interesuar për partneritete me vendet e tjera?

I ri që kërkon mundësi për vullnetarizëm?

Ndoshta punoni në bibliotekën e shkollës apo jeni trajner i të rriturve apo ndoshta udhëhiqni një kompani që kërkon partner nga vendet e tjera a bashkëpunim me universitete.



Edhe ata që punojnë me nxënësit që kanë braktisur shkollën apo në krijimin e një shoqërie më përfshirëse do të gjejnë programe, përmes të cilave mund të përkrahen projektet e tyre.

Shih brenda – mund të ketë diçka edhe për ty.



'Çka ka për, mua?'



PËRFITUESIT E DREJTPËRDEJTË	PROGRAMI	KUSH MUND TË APLIKOJË	SHEMBUJ TË AKTIVITETEVE DHE VENDI KU MUND TË GJENDEN INFORMATA MË TË HOLLËSISHME	FAQE
Nxënësit e shkollave	Comenius	Autoritete shkollore dhe të arsimit	Këmbimi i përvojave me vendet e jashtme për klasat dhe individët	8
Të rinjtë, grupet rinore, organizatat rinore	Rinia në Veprim	Grupet rinore, organizatat rinore	Këmbimet, vullnetarizmi në vendet e jashtme	12
Punëtorët e rinj	Rinia në Veprim	Organizatat rinore	Këmbimet, zhvillimi i politikave dhe partneriteteve rinore.	12
Mësimdhënësit	Comenius	Mësimdhënësit	Trajnimi jashtë vendit pa shkëputje nga puna	8
Institutet për trajnimin e mësimdhënëseve	Comenius	Autoritet e arsimit	Këmbim, hartim i përbashkët i kurrikulës	8
Shoqatat e prindërve dhe organizata joqeveritare që punojnë në arsimin shkollos	Comenius	Shoqatat e prindërve dhe organizata joqeveritare që punojnë në arsimin shkollos	Partneritete me shkollat jashtë vendit	8
Praktikantët, të trajnuarit në arsimin dhe trajnimin profesional	Leonardo da Vinci	Institutet për arsim dhe trajnim profesional	Përvoja e punës jashtë vendit	18
Punonjësit e instituteve për arsim dhe trajnimin profesional	Leonardo da Vinci	Institutet për arsim dhe trajnim profesional	Vizitat studimore dhe këmbimet e studentëve jashtë vendit, rrjetet e fokusuara në risi	18
	Erasmus	Institutet e arsimit të lartë	Periudhat e studimit dhe kryerja e praktikës jashtë vendit	22
	Erasmus Mundus	Institutet e arsimit të lartë	Studime pasuniversitare në mbarë botën	36
Studentët e universiteteve	Tempus	Institutet e arsimit të lartë	Modernizimi i metodave të mësimdhënies në vendet fqinje të BE-së	40
	Bashkëpunimi me vendet e industrializuara	Institutet e arsimit të lartë	Këmbime të studentëve me Amerikën e Veriut dhe vendet e Azisë e Paqësorit	38
	Erasmus	Punonjësit e universiteteve	Periudha të mësimdhënies jashtë vendit, vijimi i trajnimeve jashtë vendit, partneritete për hartimin e kurrikulës	22
Punonjësit e universiteteve	Erasmus Mundus	Punonjësit e universiteteve	Shkëmbimet akademike dhe partneritetet mbarëbotërore	36
	Tempus	Institutet e arsimit të lartë	Partneritete me universitete të vendeve fqinje të BE-së	40
	Bashkëpunimi me vendet e industrializuara	Punonjësit e universiteteve	Hartimi i kurrikulës dhe harmonizimi i kualifikimeve me Amerikën e Veriut dhe vendet e Azisë e Paqësorit	38
Vijuesit e rritur të arsimit, me shkollim të paktë formal	Grundtvig	Institutet për arsimin e të rriturve	Punëtoritë me të nxënësit e rritur nga vendet e tjera	26
Punëtorët e arsimit për të rritur	Grundtvig	Punëtorët e arsimit për të rritur	Partneritete dhe rrjete për trajnim pa shkëputje nga puna dhe për këmbimin e ideve	26
Mësimdhënësit për integrim evropian	Zhan Mone (Jean Monnet)	Mësimdhënësit për integrim evropian	Detyrat e mësimdhënies dhe bashkëpunimi në hulumtime	34



PËRFITUESIT E DREJTPËRDEJTË	PROGRAMI	KUSH MUND TË APLIKOJË	SHEMBUJ TË AKTIVITETEVE DHE VENDI KU MUND TË GJENDEN INFORMATA MË TË HOLLËSISHME	FAQE
Profesionistët dhe studentët e filmit dhe televizionit	MEDIA	Profesionistët, studentët, kompanitë dhe organizatat për trajnim të lidhura me fushën e filmit, televizionit dhe atë të medieve	Produksion, promovim, distribuim dhe trajnim	46
Artistët, dizajnerët, interpretuesit	Kulturë	Organizatat dhe institucionet kulturore, si dhe shtëpitë botuese	Këmbimi i ideve dhe udhëheqja e partneriteteve në fushën e artit, muzikës, dramës dhe teatrit, trashëgimisë kulturore dhe ruajtjes së saj, literaturës dhe leximit, arkitekturës dhe dizajnit.	42
Hulumtuesit	Marie Curie Actions	Hulumtuesit, organizatat hulumtuese, kompanitë	Trajnimet, këmbimet e studentëve, partneritetet	48
Punonjësit e lartë të arsimit dhe të trajnimeve	Bashkëpunimi në politika dhe zbulime në fushën e të mësuarit gjatë tërë jetës	Institucionet e arsimit dhe të trajnimeve	Vizitat studimore — (kjo i referohet programit ndërsektoral)	30
Shkollat e gjuhëve	Gjuhët	Të gjitha organizatat e përfshira në trajnime për gjuhë	Hartimi i materialeve mësimore (kjo i referohet programit ndërsektoral)	30
Politikëbërësit në fushën e arsimit dhe hulumtuesit	Teknologjitë e informimit dhe të komunikimit	Politikëbërësit në fushën e arsimit dhe hulumtuesit	Shfrytëzimi i teknologjisë për krijimin e arsimit dhe praktikave të reja të trajnimit (kjo i referohet programit ndërsektoral)	30
Të gjitha organizatat e përfshira në arsim dhe trajnime	Shfrytëzimi i rezultateve	Të gjitha organizatat e përfshira në arsim dhe trajnime	Shpërndarja e rezultateve të projektit (kjo i referohet programit ndërsektoral)	30
Afarizëm	Erasmus	Kompanitë	Organizimi i vijesve të trajnimeve të nivelit universitar, bashkëpunimi me universitetet, mësimdhënia jashtë vendit	22
	Leonardo da Vinci	Kompanitë	Organizimi i praktikantëve dhe i vijesve të trajnimit në trajnimin fillestar profesional, dërgimi i të punësuarve jashtë vendit, bashkëpunimi në partneritete për trajnime dhe projekte	18
	Tempus	Kompanitë, shoqatat industriale, odat ekonomike	Bashkëpunimi me universitete e vendeve fqinje të BE-së	40

Shumë institucione, organizata dhe shoqata të tjera mund të aplikojnë. Po ashtu, mund të aplikojnë ndërmarrjet, partnerët social, qendrat hulumtuese, organizatat jofitimprurëse, organizatat këshillimore, organizatat vullnetare dhe organizatat joqeveritare. Të gjitha programet janë të hapura për të gjitha shtetet anëtare të BE-së, ndërsa shumë prej tyre janë të hapura edhe për vendet e tjera. Për më shumë hollësi, mund të shihni përmbledhjet e programeve veç e veç dhe tabelat në faqen 52 për të parë se cilat vende mbulojnë nga secili prej programeve.





Evropa po kalon nëpër një periudhë ndryshimesh — që njëkohësisht është sfiduese dhe emocionuese. Kalimi drejt një Evrope konkurruese dhe me një zhvillim e punësim të qëndrueshëm ka fituar një vull të ri pas miratimit të Strategjisë Evropa 2020. Kjo Strategji parasheh që Evropa të kalon në një ekonomi të teknologjisë së lartë dhe me emetime të ulëta të dioksidit të karbonit, e cila priorizon risitë, kreativitetin dhe lëvizshmërinë. Përqendrimi është gjithnjë e më i madh në arsim dhe trajnime, në hulumtime dhe në burimin që rinia paraqet për BE-në. Evropa është e interesuar për hapjen e mundësive të reja për qytetarët e saj, duke ofruar mundësi të reja të mësimit. Programet e arsimit, trajnimit, kulturës, hulumtimit dhe rinisë janë përbërës i rëndësishëm i kësaj Strategjie.

Në këtë libërth paraqiten në pika të shkurtëra mundësitë në dispozicion. Pra, ju udhëzon se çka aty për ju në dispozicion dhe si ta merrni atë.



‘Çka
ka për,
mua?’



Çka ka për ju

PROGRAMET

Comenius — arsim në shkollë	faqe 8
Youth in Action — aktivitetet mësimore jashtë shkollës	faqe 12
Leonardo da Vinci — arsimim dhe trajnim profesional	faqe 18
Erasmus — arsimi i lartë në Evropë	faqe 22
Grundtvig — arsimimi për të rritur	faqe 26
Gjuhët, teknologjia informative dhe e komunikimit, si dhe shpërndarja	faqe 30
Jean Monnet — mësimdhënia për integrimet evropiane	faqe 34
Erasmus Mundus — lëvizshmëria mbarëbotërore e arsimit universitar	faqe 36
Bashkëpunimi me vendet e industrializuara	faqe 38
Tempus — modernizimi i arsimit të lartë në vendet fqinje të BE-së	faqe 40



Kulturë — këmbimet në fushën e arteve	faqe 42
MEDIA — zhvillimi i produksioneve filmike dhe televizive të Evropës	faqe 46
Marie Curie Actions — mundësitë për karriera në fushën e hulumtimeve	faqe 48
SHTOJCAT	
Vendet pjesëmarrëse	faqe 52
Kontaktet, faqet e internetit dhe botimet	faqe 53

Programi i të mësuarit gjatë tërë jetës

Komisioni Evropian ka integruar nismat e veta arsimore dhe të trajnimit nën një ombrellë të vetme, gjegjësisht nën Programin e të mësuarit gjatë gjithë jetës (www.ec.europa.eu/llp). Ky program ua mundëson individëve që në të gjitha fazat e jetës së tyre të ndjekin mundësitë e të mësuarit në mbarë Evropën. Ky Program përbëhet prej katër nënprogrameve: Comenius (për shkolla), Erasmus (për arsimin e lartë), Leonardo Da Vinci (për arsimin dhe aftësimin profesional) dhe Grundtvig (për arsimin e të rriturve).

Një program ndërsektoral plotëson këto katër nënprograme për t'u siguruar që ato të arrijnë rezultatet më të mira; përmes këtij programi përkrahet bashkëpunimi në fushën e politikave, gjuhëve, teknologjive informative dhe të komunikimit, si dhe në shpërndarjen dhe shfrytëzimin e efektshëm të rezultateve të projektit. Përmes programit Zhan Mone (Jean Monnet) stimulohet mësimdhënia, reflektimi dhe debati për procesin e integritimeve evropiane në institucionet e arsimit të lartë në mbarë botën. Çdo vitë publikohet ftesa e përgjithshme për propozime lidhur me programin e mësimit gjatë tërë jetës.

Të gjitha aktivitetet paraqiten në udhëzuesin e Programit për të mësuarit gjatë gjithë jetës, në faqen e internetit: http://ec.europa.eu/education/llp/doc848_en.htm



Comenius

Arsimi në shkolla

Çka parasheh?

Programi Comenius ka për qëllim ngritjen e cilësisë së arsimit shkollor, fuqizimin e dimensionit të tij evropian dhe avancimin e lëvizshmërisë, e të mësuarit të gjuhëve dhe përfshirjen më të madhe përmes programeve të këmbimit të nxënësve dhe bashkëpunimit mes shkollave të vendeve të ndryshme.

Çka përkrah?

Lëvizshmërinë e individëve

- Aftësimet pa shkëputje nga puna, të organizuara nga Comenius në një vend tjetër u mundësojnë mësime të mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë të arsimit përmirësimin e shkathtësive të tyre praktike dhe një kuptueshmëri më të gjerë për arsimin shkollor në Evropë përmes, bie fjala, kurseve për zhvillim profesional, konferencave dhe përcjelljes së të punësuarve në vendpunë.
- Asistencat e Comenius-it ua mundësojnë mësime të mësimdhënësve të ardhshëm të kalojnë mes 3 dhe 10 muaj në një shkollë jashtë vendit, ku ata asistojnë në mësimdhënie në shkollën nikoqire.
- Lëvizshmëria individuale e nxënësve, e mundësuar përmes Comenius-it, u jep mundësinë nxënësve të shkollave të mesme të kalojnë prej 3 deri në 10 muaj në shkollën nikoqire dhe në familjen nikoqire jashtë vendit.

Partneritetet

- Partneritetet multilaterale të shkollave ua mundësojnë nxënësve dhe mësime të mësimdhënësve që të marrin pjesë në aktivitetet e përbashkëta me shkollat nga vendet e ndryshme evropiane. Kjo ndihmon në kultivimin e vetëdijësisë kulturore dhe në përmirësimin e shkathtësive në fushat e përzgjedhura.





'Komunikimi ndërkulturor përmes partneritetit artistik' ka qenë partneritet multilateral i Comenius-it, ku përmes shfaqjeve artistike është rritur njohuria dhe të kuptuarit e ndikimit të ndërsjelltë. Bashkëpunimi mes shkollave nga Finlanda, Gjermania, Spanja, Italia dhe Belgjika ka çuar në krijimin, prodhimin, shfaqjen dhe regjistrimin e shfaqjes muzikore të quajtur Stacioni – një rrëfim për njerëzit që jetojnë në pjesë të ndryshme të Evropës. Këngët, vallëzimet, skenari, rregullimi i skenës dhe të gjitha veshjet janë krijuara nga nxënësit, përmes shfrytëzimit të theksuar të mjeteve të TIK-ut. Ushtrimet përfundimtare dhe shfaqja janë dhënë në takim në Finlandë. Shfaqjet më të vogla të shfaqjes muzikore dhe ato teatrore gjithashtu janë organizuar në çdo vend partner. Projekti ka tërhequr vëmendjen e punonjësve, nxënësve dhe të mediave lokale.

- Partneritet bilaterale gjuhësore të shkollave inkurajojnë përdorimin e gjuhëve evropiane, duke u dhënë nxënësve mundësinë që t'i praktikojnë ato jashtë vendit përmes këmbimeve dhe mes nxënësve që punojnë së bashku në shkolla. Nikoqirë të këtyre nxënësve janë familjet e njëri-tjetrit.
- Partneritetet Comenius regio u ndihmojnë palëve lokale dhe regjionale me interes në arsimin shkollor – mësimdhënësve, nxënësve dhe atyre që janë përgjegjës për sistemin arsimor – të këmbëjnë praktikatat më të mira.
- Binjakëzimi elektronik shfrytëzon mundësitë e internetit për t'u ndihmuar mësimdhënësve në mbarë Evropën të takohen njëri me tjetrin, të këmbëjnë idetë dhe burimet dhe të krijojnë projekte bashkëpunuese me nxënësit e tyre. Ky projekt nuk ofron mbështetje financiare, por jep përkrahje, organizon trajnime, ofron mekanizma dhe shembuj të praktikës së mirë.



Projektet dhe rrjetet multilaterale

- Projektet multilaterale të Comenius-it bashkojnë punonjësit e arsimit, institucionet e trajnimit, shkollat dhe organizatat e tjera që janë aktive në arsimin shkollor me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në klasë dhe të ndihmesës në fitimin e përvojave të mësimdhënësve në vendet e jashtme. Rrjetet multilaterale të Comenius-it, sjellin së bashku konzorciumet aktive në arsimin shkollor dhe janë forume për reflektime të përbashkëta me qëllim të avancimit të risive dhe praktikave më të mira në fushat tematike.

Masat përcjellëse

- Masat përcjellëse të Comenius-it i ndihmojnë programit të Comenius-it të arrijë objektivat e tij. Për shembull, përmes ngritjes së vetëdijësimit për rëndësinë e bashkëpunimit të shkollave në nivel Evropian.
- Vizitat përgatitore ua mundësojnë partnerëve të mundshëm në projektin Comenius të takohen dhe të përkufizojnë objektivat dhe planin e punës për projektin e tyre të ardhshëm.

Kush mund të marr pjesë?

Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë anëtarët aktivë të komunitetit shkollor: nxënësit, mësimdhënësit, autoritetet komunale, shoqatat e prindërve, organizatat jofitimprurëse, organizatat joqeveritare të përfshira në arsimin shkollor, institutet për trajnimin e mësimdhënësve, universitetet, qendrat e hulumtimit dhe të gjithë punonjësit e tjerë të arsimit.

Vendet me të drejtë pjesëmarrjeje janë 27 vendet e BE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Turqia. Pjesëmarrja e Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe e Konfederatës së Zvicrës përkufizohet në ftesën vjetore për propozime.

Si mund të aplikoj?

Nxënësit duhet t'i drejtohen mësimeve të tyre.

Mësimeve, shkollat dhe organizatat e tjera të interesuara në:

- Lëvizshmëri, partneritete apo vizita përgatitore duhet t'i drejtohen agjencisë shtetërore të vendit të tyre:
http://ec.europa.eu/education/lifelong-learningprogramme/doc1208_en.htm
- Projektet multilaterale, rrjetet apo masat përcjellëse duhet t'i drejtohen Agjencisë ekzekutive për arsim, çështje audiovizuale dhe kulturë:
<http://eacea.ec.europa.eu/index.htm>
- Binjakëzimi elektronik: <http://www.etwinning.net>

Ku mund të marr më shumë informata?

http://ec.europa.eu/education/comenius/doc854_en.htm



Comenius



Youth in Action

Aktivitetet mësimore jashtë shkollës

Për çka janë të parapara?

Programi Rinia në veprim ka për qëllim të frymëzojë ndjenjën e qytetarisë aktive evropiane, të solidaritetit dhe të tolerancës në mes të Evropianëve, duke filluar nga moshë e mitur e deri te moshë e të rriturve. Përmes këtij programi avancohet lëvizshmëria brenda kufijve të BE-së dhe jashtë tyre, si dhe inkurajohet përfshirja e të gjithë të rinjve, pavarësisht nivelit të tyre arsimor apo prejardhjes shoqërore a kulturore. Po ashtu, ky program i ndihmon të rinjve në fitimin e njohurive të reja dhe u jep atyre mundësi për të mësuarit joformal dhe informal në kuadër të dimensionit evropian.

Çka përkrah?

Rinia për Evropë përkrahë këmbimet, nismat rinore dhe projektet rinore të demokracisë për njerëzit e moshës mes 13 dhe 30 vjeçare, përmes të cilave inkurajohet pjesëmarrja në jetën demokratike, fryma e ndërmarrësisë dhe qytetaria aktive evropiane.

- Këmbimet rinore janë projekte të bazuara në partneritet mes dy apo më shumë partnerëve nga vendet e ndryshme. Këto projekte përfshijnë pjesëmarrjen aktive të rinisë dhe janë të parapara t'i ofrojnë rinisë mundësi të diskutojnë dhe të mësojnë për tema të ndryshme.

Projekti i quajtur 'Nuk jam i rrezikshëm, por vetëm ndryshoj nga ju!' bashkoi vallëzuesit e brejkdensit dhe këngëtarët e hard-rokut në kuadër të projektit për këmbimin e rinisë, të cilët përdorin artin si mjet të të shprehurit. Këmbimet u bënë në mes të 24 personave, të moshës prej 15 deri 25 vjeçare nga Letonia, Lituania, Gjermania dhe Spanja, si dhe në mes të 6 udhëheqësve të rinj. Ekspozimi ndaj artit, mediave, muzikës, teatrit dhe vallëzimit u ka ndihmuar të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të zhvillojnë tolerancë më të madhe për dallimet kulturore.





- Projektet e nismave rinore përkrahin aktivitetet e filluara, të krijuara dhe të realizuara nga vetë të rinjtë, ku ata luajnë rolet kryesore. Nisma rinore mund të fillohet nga një grup i vetëm në nivel lokal, regional apo shtetëror në një vend, apo nga dy ose më shumë grupe nga vende të ndryshme.
- Projektet rinore të demokracisë përkrahin pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike të komunitetit të tyre lokal, regional apo shtetëror ose edhe në nivel ndërkombëtar. Projektet demokratike të rinisë krijohen përmes partneritetit evropian. Ato mundësojnë grumbullimin e ideve, përvojave dhe metodologjive në nivel evropian nga aktivitete e zhvilluara në nivel lokal, regional dhe shtetëror.

Shërbimi vullnetar evropian ua mundëson të rinjve realizimin e aktiviteteve vullnetare jashtë vendit për një periudhë kohore deri në 12 muaj. Përmes këtij shërbimi kultivohet solidariteti mes brezave dhe mirëkuptimi i ndërsjelltë, si dhe ofrohen përvoja reale të të mësuarit për pjesëmarrësit.

Përveç se përfitojnë në kuadër të komuniteteve të tyre lokale, vullnetarët fitojnë njohuri të reja, mësojnë gjuhë të tjera dhe zbulojnë kultura të ndryshme. Projekti për Shërbimin vullnetar evropian mund të përqendrohet në tema dhe fusha të nduarnduarshme, siç janë: kultura, rinia, sporti, kujdesi social, trashëgimia kulturore, arti, mbrojtja civile, mjedisi apo bashkëpunimi zhvillimor.

'Qendra rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuara' është projekt i organizuar nga një shtëpi greke e përkujdesjes për fëmijë me aftësi të kufizuara. Përmes këtij projekti janë pritur më shumë se 60 vullnetarë nga vende të ndryshme, duke përfshirë edhe 10 prej tyre me aftësi të kufizuara mendore apo fizike. Vullnetarët jetojnë në një qendër, dhe u ndihmojnë punonjësve të saj në detyrat e tyre të përditshme, siç janë dërgimi i fëmijëve në shkollë apo në terapinë fizike ose profesionale. Vullnetarët mësojnë të zhvillojnë marrëdhënie, të ndajnë përgjegjësitë dhe të ndërlihen me njerëz nga mbarë bota.



Rinia në botë përkrahë këmbimet, trajnimet, rrjetëzimet dhe bashkëpunimin me vendet partnere, me vëmendje të posaçme në vendet partnere fqinje.

- Bashkëpunimi me vendet fqinje partnere të Bashkimit Evropian ka për qëllim zhvillimin e mirëkuptimit të ndërsjelltë, duke ndihmuar njëkohësisht në zhvillimin e sistemeve për përkrahjen e aktiviteteve të rinisë. Përmes këtij bashkëpunimi përkrahen vetëm: këmbimet si dhe trajnimi e rrjetëzimi me vendet fqinje partnere.
- Përmes bashkëpunimit me vendet e tjera që nuk janë fqinje të Bashkimit Evropian përkrahen projektet që avancojnë bashkëpunimin në sektorin e rinisë me një numër më të gjerë vendesh. Në veçanti, përkrahet këmbimi i praktikave të mira dhe trajnimi i rinisë dhe punëtorëve të rinj, partneritetet, si dhe rrjetet e organizatave rinore.

Sistemet për përkrahjen e rinisë avancojnë zhvillimin e skemave të këmbimeve, të trajnimeve dhe të informimit për rininë, punëtorët e rinj dhe organizatat e reja.

- Përkrahja për organet aktiv të rinisë në nivel evropian inkurajon punën e organizatave joqeveritare aktive në këtë nivel që kanë qëllime të përgjithshme të interesit evropian. Aktivitete e tyre duhet t'i kontribuojnë pjesëmarrjes së rinisë në jetën publike dhe në shoqëri, si dhe në zhvillimin e zbatimit të aktiviteteve bashkëpunuese evropiane në fushën e rinisë në kuptim më të gjerë.
- Trajnimi dhe rrjetëzimi i atyre që janë aktiv në çështjet dhe organizatat rinore. Këtu përfshihet përcjellja e punëtorëve gjatë orarit të punës dhe përvojat e tjera praktike të të mësuarit; vizitat e fizibilitetit apo realizueshmërisë, aktivitetet për krijimin e partneriteteve; seminarët; trajnimet apo aktivitetet e rrjetëzimit që kanë për qëllim krijimin e rrjeteve të reja apo të fuqizojnë ose zgjerojnë rrjetet ekzistuese në kuadër të programit 'Rinia në veprim'.
- Projektet që inkurajojnë inovacionet dhe cilësinë kanë për qëllim futjen, realizimin dhe avancimin e qasjeve inovative në fushën e rinisë.



- Aktivitetet informative për rininë dhe ata që janë aktiv në punët rinore, si dhe aktivitetet përkrahëse të organizatave rinore në nivel evropian dhe shtetëror, përmes të cilave përmirësohet qasja e rinisë në shërbime të informatave dhe të komunikimit, si dhe rritet pjesëmarrja e tyre në përgatitjen dhe shpërndarjen e produkteve informuese lehtë të përdorshme dhe të synuara.
- Krijimi i projekteve të partneriteteve me organet publike regjionale apo lokale (siç janë regjionet dhe komunat) apo me organizatat aktiv në sektorin e rinisë në nivel evropian ndihmon në zhvillimin apo fuqizimin e veprimeve afatgjata në fushën e të mësuarit joformal dhe të rinisë.

Bashkëpunimi evropian në fushën e rinisë përkrahë zhvillimin e bashkëpunimit të politikave të rinisë në nivel evropian:

- Takimet e rinisë dhe atyre përgjegjës për përkrahjen e politikave të rinisë, për seminare dhe për dialogun e strukturuar mes të rinjve, njerëzve aktiv në çështjet rinore, organizatave rinore dhe njerëzve përgjegjës për politikatat rinore;
- Përkrahje për aktivitetet që ndikojnë në rritjen e njohurive të aspekteve rinore;
- Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare të angazhuara në çështjet rinore, në veçanti me Këshillin e Evropës, Kombet e Bashkuara apo me institucionet e saj të specializuara.

Kush mund të marr pjesë?

Rinia për Evropë

Është i orientuar tek personat e moshës prej 13 deri në 30 vjeçare. Aplikacionet mund të parashtrihen nga organizatat jofitimprurëse/organizatat joqeveritare; organi lokal apo regjional publik; grupi joformal i të rinjve apo nga organi aktiv në fushën e rinisë në nivel evropian, i cili është ligjërish i themeluar në njërin prej vendeve me të drejtë pjesëmarrjeje: 27 vendet anëtare të BE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Turqia.

Youth in Action

‘Çka
ka për
mua?’

15



Shërbimi vullnetar evropian

Ky shërbim kryesisht synon popullatën mes moshën 18 dhe 30 vjeçare. Aplikimet mund të parashtrohen nga organizatat jofitimprurëse; institucioni publik lokal apo regjional; institucioni aktiv në nivel Evropian në fushën e rinisë; organizatë ndërkombëtare qeveritare apo (por vetëm për ngjarje në fushën e rinisë, sportit dhe kulturës) organizata fitimprurëse në njërin prej vendeve me të drejtë pjesëmarrjeje: 27 vendet e BE-së, Islanda, Lihtenshajni, Norvegjia, Turqia, vendet e përfshira në politikën Evropiane të fqinjësisë (Evropa Lindore, Kaukazi, regjioni i Mesdheut dhe Evropa Juglindore), si dhe vendet e tjera që kanë nënshkruar marrëveshje të caktuara me Bashkimin Evropian.

Rinia në botë

Ky program kryesisht synon popullatën mes moshës 13 dhe 30 vjeçare. Aplikimet mund të parashtrohen nga organizatat jofitimprurëse; institucioni publik lokal apo regjional; grup joformal i të rinjve apo institucioni aktiv në nivel Evropian në fushën e rinisë, i themeluar në njërin prej vendeve me të drejtë pjesëmarrjeje: 27 vendet e BE-së, Islanda, Lihtenshajni, Norvegjia, Turqia, vendet e përfshira në politikën evropiane të fqinjësisë (Evropa Lindore, Kaukazi, regjioni i Mesdheut dhe Evropa Juglindore), si dhe vendet e tjera që kanë nënshkruar marrëveshje të caktuara me Bashkimin Evropian.


Sistemet për përkrahjen e rinisë

Këto sisteme janë të parapara për popullatën e njërit prej vendeve me të drejtë pjesëmarrjeje: 27 vendet e BE-së, Islanda, Lihtenshajni, Norvegjia, Turqia. Për këtë veprim nuk ekziston kufizimi i moshës, dhe gjithashtu është në dispozicion edhe për punëtorët e rinj.

Bashkëpunimi Evropian në fushën e rinisë

Në këtë rast kryesisht synohen popullata e moshës 15 deri në 30 vjeçare. Aplikimet mund të parashtrohen nga organizatat jofitimprurëse; institucioni publik lokal apo regjional ose nga institucioni aktiv në nivel Evropian në fushën e rinisë, në njërin prej vendeve me të drejtë pjesëmarrjeje: 27 vendet e BE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Turqia.

Youth in Action



Si të aplikoj?

Pjesa më e madhe e menaxhimit të programeve është e decentralizuar përmes rrjetit të agjencive shtetërore. Agjencitë shtetërore mund të kontaktohen në:
http://ec.europa.eu/youth/youth/contacts_en.htm

Menaxhimi i disa degëve të programit 'Rinia në veprim' është i centralizuar përmes Agjencisë ekzekutive për arsim, çështje audiovizuale dhe kulturë:
<http://eacea.ec.europa.eu/youth>

Ku mund të marr më shumë informata?

Udhëzuesi i programit 'Rinia në veprim':
http://ec.europa.eu/youth/youth-in-action-programme/doc443_en.htm

Faqja e internetit e BE-së për rininë: <http://ec.europa.eu/youth>

Agjencia ekzekutive për arsim, çështje audiovizuale dhe kulturë:
<http://eacea.ec.europa.eu/youth>

Zyra pritëse për rininë: youthhelpdesk@ec.europa.eu

Informatat mbi ftesat për propozime:
youthcallforproposals@ec.europa.eu



'Çka
ka për
mua?'

17



Leonardo da Vinci

Arsimimi dhe trajnimi profesional

Për çka është i paraparë?

Programi Leonardo da Vinci u ndihmon qytetarëve të Evropës të fitojnë aftësi, njohuri dhe kualifikime të reja, si dhe njohjen e tyre përtej kufijve me qëllim të përmirësimit të punësimit, duke pasur parasysh tregjet në ndryshim e sipër të punës. Po ashtu, përmes këtij programi përkrahen risitë dhe përmirësimet në sistemeve dhe praktikave për arsimin dhe trajnimin profesional.

Çka përkrah?

Përmes programit Leonardo da Vinci përkrahen nevojat e mësimdhënies dhe të trajnimit të personave të përfshirë në arsimin dhe trajnimin profesional. Të gjitha lëndët e përfshira në arsimin dhe trajnimin profesional kanë mund të përkrahen nëse përfshijnë bartjen ndërkombëtare të njohurive, të risive dhe të ekspertizës.

- 'Lëvizshmëria fillestare për trajnime profesionale parashihet për trajnerë, praktikantë dhe nxënës/studentë në arsimin dhe aftësimin profesional.
- 'Lëvizshmëria për njerëzit në tregun e punës' vë theksin në lëvizshmërinë e të mësuarit për personat që kanë gradë universitare apo për të diplomuarit universitarë, qofshin ata të punësuar apo jo.
- 'Lëvizshmëria Vetpro' përkrahë këmbimin e përvojave mes profesionistëve në fushën e arsimit dhe të trajnimit profesional, siç janë mësimdhënësit dhe trajnerët, punonjësit që merren me arsimin dhe trajnimin profesional dhe specialistët për udhëzime.





Falck, një shërbim privat donez për zjarrëfikje dhe shpëtim, dhe shërbimi për zjarrëfikje dhe shpëtim Shropshire, shërbim ky britanez publik, së bashku kanë themeluar projektin Leonardo da Vinci. Çdo vitë ata këmbëjnë 12 trajnerë të punonjësve, në ekipe të ndarë nga dy. Ata mësojnë dhe përfitojnë nga përvojat e njëri-tjetrit.

- Partneritetet janë projekte për bashkëpunime në shkallë të ulët mes organizatave partnere në vende të ndryshme lidhur me tematikat e interesit të përbashkët që janë të ndërlidhura me aftësimin dhe arsimin profesional.
- ‘Transferi i risive’ përqendrohet në projektet multilaterale të bashkëpunimit për transferimin apo përshtatjen e zgjedhjeve inovative mes vendeve të ndryshme në sistemet e arsimit dhe të trajnimit profesional.
- ‘Zhvillimi i risive’ ka të bëjë me projektet multilaterale ndërkombëtare që zhvillojnë zgjidhje inovative në sistemet e arsimit dhe trajnimit profesional në nivel evropian.
- Rrjetet multilaterale vejnë theksin në rrjetet transnacionale për këmbimin e përvojave dhe të informatave në arsimin dhe trajnimin profesional përmes qasjes tematike apo sektoriale.
- Vizitat përgatitore mund të financohen për të gjetur partnerët dhe përgatitur projektet.




Kush mund të marr pjesë?

Programi Leonardo da Vinci është i paraparë për persona që gjenden në fazën fillestare të arsimit dhe trajnimit profesional:

- Praktikantët dhe nxënësit e shkollave të mesme;
- Personat që gjenden në tregun e punës (me përgatitje të trajnimit profesional apo më të lartë);
- Mësimdhënësit, trajnerët dhe punonjësit e tjerë përgjegjës për trajnim profesional;
- Institucionet dhe organet, siç janë shoqatat dhe përfaqësuesit e palëve të përfshira në arsimin dhe trajnim profesional, duke përfshirë shoqatat e trajnerëve, të prindërve dhe të mësimdhënësve;
- Ndërmarrjet, partnerët socialë dhe përfaqësuesit e tjerë të lëmenjve të ndryshëm, duke përfshirë odat ekonomike dhe organizatat e tjera tregtare;
- Qendrat dhe organet hulumtuese që merren me të mësuarit gjatë tërë jetës dhe me çfarëdo aspekti të arsimit dhe trajnimit profesional në nivel lokal, regional dhe shtetëror.
- Organizatat jofitimprurëse, organet vullnetare dhe organizatat joqeveritare.

Vendet me të drejtë pjesëmarrjeje janë 27 vendet e BE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Turqia, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.



Si mund të aplikoj?

Individët e interesuar mund të aplikojnë përmes një organizate që menaxhon me fondet e Leonardos (institucion i tyre trajnues, zyre e punëdhënësve apo e punës, për shembull). Faqet e internetit të agjencive shtetërore përmbajnë më shumë hollësi në këtë drejtim.

Institucionet e trajnimit dhe organizatat e tjera duhet t'i drejtohen agjencisë shtetërore në vendin e tyre. Adresa e tyre mund të gjendet në faqen e internetit: http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc1208_en.htm


Veprimet e centralizuara, siç janë rrjetet multilaterale apo projektet për 'Zhvillimin e inovacioneve' menaxhohen nga Agjencia ekzekutive për arsim, çështje audiovizuale dhe kulturë, me bazë në Bruksel.
Shih: http://eacea.ec.europa.eu/llp/index_en.php

Ku mund të marr më shumë informata?

http://ec.europa.eu/education/leonardo-da-vinci/doc1018_en.htm

Leonardo da Vinci

'Çka
ka për
mua?'



21

Erasmus



Arsimi i lartë në Evropë

Për çka është i paraparë?

Erasmus përkrah lëvizshmërinë e shtuar në arsimin e lartë — posaçërisht në mesin e studentëve, por edhe në mes të profesorëve dhe punonjësve të tjerë universitarë. Qëllimi i këtij programi është kultivimi i qasjes mbarë evropiane në arsimin e lartë. Ofrimi i mundësisë së shkuarjes në vendet dhe kulturat e tjera për studentët jo vetëm se pasuron përvojën e tyre studimore, por gjithashtu avancojnë një fuqi punëtore me një mendësi më të zhvilluar evropiane, më fleksibile dhe më të lëvizshme që përmirëson potencialin konkurrues dhe inovativ në Evropë.

Çka përkrah?


Inkurajon lëvizshmërinë ndërkufitare të studentëve brenda Evropës – në arsimin formal të lartë dhe në arsimin e trajnimit profesional të avancuar në nivel passekondar, si dhe të punonjësve të arsimit dhe atyre joakademikë. Që nga themelimi i këtij programi, mbi 2 milionë studentë kanë marrë pjesë në të.

Lëvizshmëria e individëve në një vend tjetër evropian

STUDENTËT

Studentët mund të kalojnë një periudhë studimi mes 3 dhe 12 muajsh në një institucion të arsimit të lartë në një vend tjetër pjesëmarrës evropian. Ata nuk kanë nevojë të paguajnë për mësimin e vijuar dhe mund t'i shfrytëzojnë kreditet e kurseve të fituara jashtë.

Lëvizshmëria e studentëve ua mundëson atyre që vijojnë arsimin e lartë të bëjnë praktikën apo trajnimin në një ndërmarrje apo organizatë tjetër në një vend tjetër të evropian.






Kurset intensive të gjuhëve janë në dispozicion për t'u ndihmuar studentëve të Erasmus-it që të përgatiten për periudhën e tyre në vendet, gjuha e të cilave më pak përdoret dhe më pak mësohet.

Vedrana Trbushiq, studente sllovene e komunikimeve në Universitetin e Lubjanës, shkruan për qëndrimin e saj në Itali, të organizuar përmes Erasmus-it: 'Sapo kam përfunduar vitin tim të fundit si studente e programit Erasmus, në Universitetin e Bolonjës, një nga universitetet më të vjetra në Evropë. Vetë fakti se kam vijuar studimet në universitetin ku kanë studiuar Danteja dhe Petrarka ka qenë një përvojë e madhe për mua, e të mos flasim për shamin e qytetit dhe të bolonjasve. Por gjëja më e mirë kanë qenë kurset dhe profesorët, si dhe mundësia e shkëlqyeshme akademike. Kam pasur mundësinë t'i vijojë kurset që nuk ekzistojnë në universitetin tim amë, ku kam përfituar njohuri unike.'

PUNONJËSIT E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Punonjësit me të drejtë pjesëmarrjeje mund të kalojnë deri në gjashtë javë në një institucion të jashtëm partner të arsimit të lartë, ku njëkohësisht përmirësojnë perspektivën e tyre për karrierë dhe avancojnë bashkëpunimin.

- Mësimdhënësit nga vendet e jashtme mund të përfitojnë, duke u ligjëruar studentëve dhe duke praktikuar metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe njësi mësimore në gjuhë të huaj. Njëkohësisht mësimdhënësit fitojnë perspektiva të ndryshme, krijojnë kontakte të reja dhe zgjerojnë rrjetet e tyre akademike. Mësimdhënësit e programit Erasmus po ashtu mund të fillojnë aktivitetet të tjera të lëvizshmërisë dhe të bashkëpunimit.
- Ata që punojnë në sektorin e biznesit gjithashtu mund të kualifikohen për programon Erasmus si ligjërues mysafirë në institucionin e jashtëm partner, ku mund t'u ofrojnë studentëve njohuri më të reja të botës së biznesit dhe të rregullojnë këmbimet e studentëve dhe trajnimin e punonjësve.



- Punonjësit jomësimdhënës të institucioneve — siç janë menaxherët apo bibliotekistët — mund të shkojnë jashtë vendit në kuadër të programit Erasmus për të vijuar trajnimet në institucione a biznese të tjera.

Institucionet e arsimit të lartë

Programet intensive në Evropë

Këto programe të shkurtëra studimore — të parapara për studentë dhe mësimdhënës — zgjasin prej dy deri në gjashtë javë, dhe organizohen nga së paku tri institucione të arsimit të lartë prej tri vendeve të ndryshme.

Programet dhe rrjetet multilaterale

Përmes programit Erasmus gjithashtu përkrahen projektet e modernizimit dhe të inovacionit në sektorin e arsimit të lartë. Punonjësit mund të përfshihen në:

- Projektet multilaterale për zhvillimin e kurrikulës, për modernizimin e arsimit të lartë, për bashkëpunim mes institucioneve të arsimit të lartë dhe ndërmarrjeve, si dhe kampuset virtuale zgjasin deri në tri vjet, dhe përfshijnë së paku tri vende;
- Rrjetet: rrjetet akademike dhe strukturore të institucioneve dhe organizatave të tjera partnere janë të parapara të ofrojnë risi në disiplina specifike akademike apo në organizim, si dhe paraqesin forume për këmbimin e praktikave më të mira.

Karta universitare e Erasmus-it

Karta paraqet parimet, për të cilat institucionet e arsimit të lartë zotohen se do t'i respektojnë. Diku rreth 4 000 institucione në 33 shtete aktualisht kanë këtë kartë, e cila është parakusht që institucionet të marrin pjesë në aktivitetet e Erasmus-it



Kush mund të marr pjesë?

Programi Erasmus është i hapur për:

- Studentët në arsimin e lartë formal dhe në arsimin e trajnimit profesional të avancuar në nivel passekondar, duke përfshirë studimet e doktoraturës;
- Mësimdhënësit, trajnerët dhe punonjësit e arsimit, duke përfshirë shoqatat, qendrat hulumtuese, organizatat këshillimore dhe palët e tjera relevante të përfshira në të mësuarit gjatë tërë jetës;
- Ndërmarrjet, partnerët social dhe palët e tjera, si dhe organet publike ose private që ofrojnë arsim dhe aftësime në nivel lokal, regional dhe shtetëror.

Vendet me të drejtë pjesëmarrjeje janë 27 vendet e BE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Turqia. Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë marrin pjesë në fazën përgatitore.

Si mund të aplikoj?

Fillimisht studentët duhet t'i qasen zyrës ndërkombëtare të universitetit ose kolegjit të tyre. Universitetet dhe organizatat e tjera duhet t'i drejtohen agjencisë shtetërore në vendin e tyre.

Adresa për agjencitë vendore mund të gjendet në faqen e internetit:

http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc1208_en.htm


Rrjetet, projektet multilaterale dhe dhënia e Kartës universitare të Erasmus-it menaxhohen nga Agjencia ekzekutive për arsim, çështja audiovizuale dhe kulturë, me bazë në Bruksel.

See http://eacea.ec.europa.eu/llp/index_en.php

Ku mund të marr më shumë informata?

<http://ec.europa.eu/education/erasmus>

Erasmus



Grundtvig

Arsimimi i të rriturve

Për çka është i paraparë?

Arsimimi i të rriturve ngritë nivelin e njohurive, shkathtësive dhe aftësive në mesin e popullatës së rritur, dhe ofron një mundësi të dytë për një numër të madh të rriturish që braktisin shkollën. Gjithashtu, ndihmon në trajtimin e sfidave të popullatës gjithnjë më të moshuar në shoqërinë e Evropës.

Çka përkrah?


Grundtvig përfshinë të gjitha nivelet dhe sektorët e arsimit për të rritur dhe të gjitha format e të mësuarit: formal, joformal dhe informal.

- Projektet multilaterale bashkojnë institucionet dhe organizatat nga vendet e ndryshme me qëllim të grumbullimit të njohurive e përvojave, si dhe të krijimit të rezultateve inovative me vlera evropiane.
- Rrjetet multilaterale ofrojnë një platformë të përbashkët për diskutime dhe këmbim informatash për çështjet, politikat dhe hulumtimet kyçe;
- Partneritetet në të mësuar bashkojnë institucionet për arsimin e të rriturve nga vendet Evropiane, të cilat përqendrohen në temat e interesit të përbashkët;
- Aftësimet pa shkëputje nga puna ua mundësojnë zhvillimin profesional trajnerëve, mësime dhënëse dhe punonjësve.





- Vizitat dhe këmbimet e punonjësve të arsimit për të rritur mund të përfshijnë detyra të mësimdhënies, të mësuarit përmes përcjelljes në vendpunë dhe vizita të tjera për këmbimin e përvojave në institucionet e arsimit të lartë.
- Asistencat fokusohen tek ata që vijojnë aftësimet fillestare për një pozitë në arsimin për të rritur apo të cilët sapo janë kualifikuar apo janë duke kaluar nga punët e tjera në fushën e arsimit për të rritur.
- Projektet për vullnetarizëm ofrojnë mundësi të reja të të mësuarit për qytetarët e moshuar në Evropë, duke avancuar të moshuarit aktiv dhe duke theksuar kontributin e të moshuarve në shoqëri.
- Përmes punëtorive bashkohen vijuesit veç e veç apo grupe të vogla të tyre nga disa vende të ndryshme me qëllim të fitimit të përvojave në të mësuarit inovativ të personave që vinë nga shtete të ndryshme, i cili është relevant për zhvillimin e tyre personal dhe për nevojat e të mësuarit, ku vijuesit po ashtu inkurajohen të këmbajnë përvojat dhe idetë e tyre.



Muzetë dhe mjediset e tjera të të mësuarit joformal kanë shumë për të ofruar në çarjen e arsimit më afër qytetarëve dhe në ofrimin e mundësive të mësimit për të gjithë. Në kuadër të projektit 'Të mësuarit gjatë tërë jetës përmes muzeve', muzetë në mbarë Evropën kanë analizuar marrëdhëniet e tyre me shoqërinë dhe me komunitetet lokale, si dhe kanë hartuar materiale të duhura të aftësimin, duke u bazuar në praktikatat dhe në studimet e rastit të hartuara në nivel evropian. Trajnimi për punonjësit arsimor të muzeve, në veçanti kanë krijuar mundësi për zhvillimin e shkathtësive gjatë punës me segmentet e nëpërfaqësuar të qytetarëve evropianë.

Kush mund të marr pjesë?

Përmes aktiviteteve të Grundtvig-ut në veçanti përkrahen:

- Personat që nuk kanë shkollim dhe kualifikime bazë;
- Personat që jetojnë në vise rurale dhe të pazhvilluara apo që kanë më pak mundësi për shkaqe socio-ekonomike.

Këto aktivitete përqendrohen tek njerëzit 'vështirë të arritshëm' dhe të cilët në mërgjithësi nuk kanë tendenca të pjesëmarrjes në aktivitete shkollore.

Vendet me të drejtë pjesëmarrjeje janë 27 shtetet anëtare të BE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Turqia, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.



Si mund të aplikoj?

Organizatat dhe individët duhet t'i drejtohen agjencisë shtetërore në vendin e tyre përkatës. Adresat mund të gjenden në faqen e internetit:

http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc1208_en.htm

Ku mund të marr më shumë informata?

http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc86_en.htm



Grundtvig

'Çka
ka për
mua?'

29



Gjuhët, teknologjia e informimit dhe komunikimit dhe shpërdarjes

Për çka është i paraparë?

Për krijimin e rezultateve më të mira nga Programi për të mësuarit gjatë tërë jetës (Comenius, Erasmus, Leonardo da Vinci dhe Grundtvig), BE-ja ofron ndihmesë shtesë.

Çka përkrah?

Bashkëpunimin në fushën e politikave dhe të risive

Financimi për bashkëpunimin në fushën e politikave dhe të risive është në dispozicion për analizën e politikave dhe sistemeve në fushën e të mësuarit gjatë gjithë jetës, të përmirësimit të materialeve referente, siç janë anketat dhe statistikat, si dhe të fuqizimit të risive në arsim dhe aftësi. Për projektet evropiane të hulumtimit dhe të studimeve krahasimore ofrohen edhe grante, si dhe përkrahen vizitat studimore për vendim-marrësit dhe palët e tjera me interes.

Përkrahja për mësimin e gjuhëve

Fondet janë në dispozicion për vetëdijesimin rreth rëndësisë së aftësive gjuhësore, përmirësimit të qasjes në resurset për mësimin e gjuhëve, si dhe për zhvillimin e materialeve për nxënie dhe mësimdhënie të gjuhëve. Përkrahja vlen për çdo gjuhë, por paraparësi i jepet të mësuarit e gjuhëve zyrtare evropiane si gjuhë të huaja.

'Të mësuarit përmes lëvizjes' ndihmon në zhvillimin e shkathtësive gjuhësore në mesin e qytetarëve gjithnjë e më të lëvizshëm të Evropës. Në kuadër të projektit është zhvilluar fushata promovuese në mjetet e transportit publik, si mënyrë për stimulimin e përdoruesve të mësojnë gjuhët e pakicave apo të vendeve fqinje. Kjo fushatë është realizuar përmes trolejbusëve në Lituanë, tramvajeve në Poloni, autobusëve në Rumani dhe Maltë, trenave nëntokësorë në Gjermani dhe përmes autobusëve dhe trenave të qytetit në Itali. Përdoruesve u tërhoqet vëmendja përmes posterëve të dukshëm në vendndaljet apo stacionet e automjeteve transportuese. Ndërsa brenda autobusit, tramvajit apo trenit posterët e tjerë të vendosur përmbajnë fjali të dobishme në gjuhë të huaja, të përcjella me audioincizime.





Teknologjitë e informimit dhe të komunikimit

Projektet mund të kualifikohen për fitimin e përkrahjes nëse përdorin teknologjinë për zhvillimin e praktikave të reja të arsimit dhe trajnimit apo nëse përmirësojnë qasjen në të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ndihmojnë në zhvillimin e sistemeve të avancuara të menaxhimit. Ky përqendrim përfshinë identifikimin dhe zbatimin e përdorimeve inovative të IKT-së për të mësuarit gjatë tërë jetës, në veçanti për grupet në rrezik të mospërfshirjes.

Shpërndarja dhe shfrytëzimi

Aktivitete për sigurimin e ndikimit maksimal të projekteve dhe veprimeve, të financuara nga BE-ja, mund të kualifikohen për përkrahje financiare. Qëllimi i kësaj është krijimi i një kornize për shfrytëzimin e efektshëm të rezultateve në nivel lokal, të sektorit, regjional, shtetëror dhe në nivel evropian.

Kush mund të marr pjesë?

Bashkëpunimi në fushën e politikave dhe të risive

Drejtorët e institucioneve të arsimit dhe të aftësisë, ekspertët dhe zyrtarët e autoriteteve shtetërore, regjionale dhe lokale, shërbimet e udhëzimit dhe të akreditimit, si dhe partnerët social mund të marrin pjesë. Po ashtu, mund të marrin pjesë edhe hulumtuesit, analistët e politikave dhe të sistemeve në fushën e të mësuarit gjatë gjithë jetës, si dhe ekspertët e institucioneve që punojnë në çështje të politikave. Disa ftesa për propozime janë të hapura edhe për autoritetet publike.



Përkrahja për mësimin e gjuhëve

Pjesëmarrja është e hapur për çdo organizatë apo institucion që punon drejtpërsëdrejti apo në mënyrë të tërthortë në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhëve/shumëgjuhësisë, siç janë shkollat e gjuhëve, qendrat për hulumtimin e shkollimit gjuhësor, institucionet lokale apo regjionale, shoqatat aktive në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies gjuhësore apo kompanitë e kulturës, radios, televizionit a të medieve të pranishme në internet, shtëpitë botuese dhe prodhuesit ose shpërndarësit e programeve kompjuterike.

Teknologjitë e informimit dhe të komunikimit

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë politikëbërësit, praktikantët, hulumtuesit, mësimdhënësit dhe trajnerët.


Shpërndarja dhe shfrytëzimi

Pjesëmarrja është e hapur për:

- Institucionet apo organizatat që ofrojnë mundësi shkollimi apo që janë përgjegjëse për sisteme dhe politika në nivel lokal, regjional dhe shtetëror; ndërmarrjet, partnerët socialë, organizatat tregtare, odat ekonomike dhe industria;
- Organet që japin udhëzime, këshillime dhe shërbime të informimit; shoqatat që punojnë në fushën e të mësuarit gjatë tërë jetës, duke përfshirë shoqatat e studentëve, vijuesit e trajnimeve, nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe vijuesit e mësimin gjatë tërë jetës;
- Qendrat dhe organet hulumtuese të fushës së të mësuarit gjatë tërë jetës;
- Organizatat jofitimprurëse, entitetet vullnetare dhe organizatat joqeveritare.

Vendet me të drejtë pjesëmarrjeje janë 27 vendet e BE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Turqia, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Gjuhët, teknologjia e informimit dhe komunikimit dhe shpërndarjes



Si mund të aplikojë?

Organizatat dhe individët e interesuar në masat përcjellëse për projektet dhe rrjetet multilaterale duhet të kontaktojnë Agjencinë ekzekutive për arsim, çështje audiovizuale dhe kulturë: <http://eacea.ec.europa.eu/index.htm>

Ku mund të marr më shumë informata?

Bashkëpunimi në politika dhe inovacion:

http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc92_en.htm

Vizitat studimore për specialistët e arsimit dhe trajnimit profesional:

http://ec.europa.eu/education/transversal-programme/doc946_en.htm

Të mësuarit e gjuhëve:

http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc94_en.htm

Teknologjitë e informimit dhe të komunikimit:

http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc96_en.htm

Shpërndarja dhe shfrytëzimi:

http://ec.europa.eu/education/lifelong-learning-programme/doc98_en.htm



Jean Monnet

Mësimdhënia e integritit evropian

Për çka është i paraparë?

Aktivitetet e programit Zhan Mone (Jean Monnet) kanë për qëllim stimulimin e ekselencës në mësimdhënie, hulumtime dhe debate lidhur me integritet evropiane në institucionet e arsimit të lartë.

Çka përkrah?

- Modulet evropiane të programit Zhan Mone: kurse të shkurtëra për integrit evropian prej së paku 40 orëve.
- Kryesuesit e programit Zhan Mone: poste të mësimdhënies, me specializim në studime për integrit evropian. Kryesuesit ligjërojnë së paku 90 orë për një vit akademik.
- Kryesuesit Ad personam të Zhan Monesë: këto janë të rezervuara për kryesuesit e Zhan Monesë me një përvojë të madhe të mësimdhënies ndërkombëtare dhe të publikimeve dhe/apo profesorët me bagazh të madh, si ish-praktikues të nivelit të lartë në fushën e integritëve evropiane.

Profesori Sinisha Rodin i Universitetit të Zagrebit ka shndërruar në mbarë Kroacinë një modul të Zhan Monesë, që ka fituar shpërblim në vitin 2001, në një instrument dinamik për përhapjen e njohurive për Bashkimin Evropian. Moduli i tij i vitit 2001 është zhvilluar në modul kryesues të Zhan Monesë dhe në dy module shtesë. Të gjithë ligjëruesit që punojnë në Departamentin e ligjit publik evropian janë anëtarë të ekipit negociator të Kroacisë për hyrje në BE. Ekipi kryesues i Zhan Monesë është duke luajtur rol të rëndësishëm në shpjegimin e integritit evropian dhe në lidhjet e tyre me të drejtat dhe liritë qytetare. Po kështu, ky ekip ka filluar seminarët e Zhan Monesë në Dubrovnik, një program të ri të magistraturës për studime Evropiane dhe Vjetarin e Kroacisë për ligjin dhe politikën evropiane.

- Qendrat e ekselencës të Zhan Monesë: struktura shumëdisiplinore që grumbullojnë resurse për integritet evropiane brenda një apo më shumë universiteteve, dhe që punojnë nën udhëzimet e kryesuesit të Zhan Monesë.





- Përkrahja për shoqatat e profesorëve dhe hulumtuesit që kanë specializuar në fushën e integritimeve evropiane.
- Përkrahja për aktivitete e informimit dhe të hulumtimit lidhur me integritet evropiane; me stimulimin e konferencave, seminareve, tryezave të rrumbullakëta për integritet Evropiane.
- Grupet hulumtuese multilaterale Zhan Mone: partneritetet mes kryesuesve të Zhan Monesë nga së paku tri vende të ndryshme që kanë për rrjedhojë sinergjitë e përbashkëta për hulumtime dhe ato shumëdisiplinore në fushën e studimeve për integritet evropiane.

Programi Zhan Mone — ku veprimi Zhan Mone është komponenti kryesor — gjithashtu përkrahë Kolegjin e Evropës, Institutin Evropian Universitar, Institutin Evropian për Administratë Publike, Akademia e Ligjit Evropian, Agjencia Evropiane për Zhvillim në Arsimin për Nevoja të Posaçme dhe Qendra Ndërkombëtare për Arsim dhe Trajnime.

Kush mund të marr pjesë?

Mund të marrin pjesë institucionet e arsimit të lartë, shoqatat e profesorëve dhe të hulumtuesve të specializuar në fushën e studimeve për integritet evropiane.

Është i hapur për të gjitha vendet e botës.

Si mund të aplikoj?

Duke iu përgjigjur ftesës për propozime.

Ku mund të marr më shumë informata?

http://ec.europa.eu/education/jean-monnet/doc609_en.htm

http://eacea.ec.europa.eu/llp/jean_monnet/jean_monnet_en.php

**‘Çka
ka për,
mua?’**

35



Erasmus Mundus

Lëvizshmëria mbarë botërore e arsimit universitar

Për çka është i paraparë?

Përmes këtij programi përmirësohet cilësia e arsimit të lartë përmes bursave dhe bashkëpunimit ekonomik mes Evropës dhe pjesës tjetër të botës.

Çka përkrah?

Erasmus Mundus përkrah:

- Programet e përbashkëta në nivelin pasdiplomik apo themelimin e partneriteteve të bashkëpunimit ndërinstitucional mes universiteteve të Evropës dhe vendeve që nuk janë anëtare të BE-së;
- Bursa për studime, periudha hulumtuese apo të mësimdhënies për studentët, hulumtuesit dhe punonjësit universitarë në kontekstin e programeve të përbashkëta në nivel të studimeve pasdiplomike apo të bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Projektet e parapara për përmirësimin e atraktivitetit, profilit, dukshmërisë dhe imazhit të arsimit të lartë evropian në mbarë botën.

Chunyu Liang nga Kina, që ka studiuar në Greqi, Hungari dhe në Mbretëri të Bashkuar, thotë: 'Pasja e mundësisë për të studiuar menaxhimin mjedisor në vende të ndryshme evropiane dhe së bashku me pjesëtarë të 27 shteteve ka qenë një përvojë e madhe. Kam vijuar një gamë të gjerë të trajnimeve të avancuara, të cilat më kanë ndihmuar të fitojë njohuri dhe shkathtësi teknike që janë thelbësore për punën time të tanishme në një kompani udhëheqëse në zbutjen e ndryshmeve klimatike.'





Kush mund të marr pjesë?

Mund të marrin pjesë institucionet e arsimit të lartë, organizatat aktive në fushën e arsimit të lartë dhe të hulumtimit, studentët, kandidatët për doktoraturë, mësimdhënësit, hulumtuesit dhe punonjësit universitarë

Është i hapur për të gjitha vendet e botës.

Si mund të aplikoj?


Organizatat dhe individët mund t'i drejtohen pikës kontaktuese në vendin e tyre.

Adresat mund të gjenden në:

http://ec.europa.eu/education/erasmus-mundus/doc1515_en.htm

Ku mund të gjej më shumë informata?

http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus



Bashkëpunimi me vendet e industrializuara

Për çka është i paraparë?

Qëllimi i tij është përmirësimi i cilësisë së sistemeve të arsimit dhe të trajnimeve, si dhe avancimi i mirëkuptimit ndërkulturor përmes dialogut ndërkombëtar, krahasimit dhe konkurrencës dhe vendet më të zhvilluara të botës.

Çka përkrah?

Përkrah programet e studimit të përbashkët me vendet e tjera të industrializuara, posaçërisht në Amerikën e Veriut dhe në regjionin e Azisë-Paqësorit.

- Projektet për diplomë të përbashkët apo të dyfishtë: këto projekte themelohen dhe udhëhiqen nga konzorciumet e institucioneve të arsimit të lartë me qëllim të krijimit të programeve të integruara të studimeve të përbashkëta, ku studentët nga të dyja vendet kalojnë një kohë mjaft të gjatë të studimit në vendin partner dhe fitojnë diplomë të përbashkët apo të dyfishtë. Kohëzgjatja e zakonshme e projektit është 4 vite.
- Projektet e përbashkëta të lëvizshmërisë: Këto projekte krijohen dhe udhëhiqen nga një grup institucionesh të arsimit të lartë a të arsimimit profesional nga BE-ja dhe nga një vend partner. Aktivitetet përqendrohen në lëvizshmërinë afatshkurtër të studentëve (kryesisht gjatë periudhës së një semestri), ku njihen këto periudha të studimeve jashtë vendit; zhvillimin e përbashkët të kurrikulës dhe këmbimet e vijuesve të trajnimeve, të mësimitdhënësve apo të administratorëve. Kohëzgjatja e zakonshme e projektit është 3 vite.

'Shkollimi i menaxherëve të shëndetësisë të së ardhmes': për t'u ndihmuar menaxherëve të ardhshëm të shëndetësisë të shohin se si dhe pse sistemet shëndetësore në secilën prej anëve të Oqeanit Atlantik janë të strukturuar dhe të menaxhuara ndryshe, gjatë periudhës së këtij projekti të përbashkët për lëvizshmërinë e studentëve janë këmbyer 27 sish. Studentët kanë fituar njohuri unike për sistemet e panjohura shëndetësore për ta, përmes vijimit të kurseve dhe vijimit të trajnimeve në spitale. Siç nënvizoi një student: 'Kjo përvojë e këmbimit të studentëve të mundëson të shohësh funksionimin e sistemit në një vend tjetër, dhe ti fillon të mendosh: si mund të e përshtati sistemin tim në mënyrë që i njëjti të funksionoj më mirë.'





- Dialogu dhe projektet e orientuara në politika me qëllim të trajtimit të çështjeve strategjike lidhur me sistemet e arsimit dhe të trajnimeve, si dhe me politikën e BE-së dhe vendeve partnere të saj: ky aktivitet përfshinë studimet, seminarët, grupet punuese dhe ushtrimet e caktimit të standardeve që trajtojnë çështjet krahasuese të arsimit të lartë dhe të trajnimit profesional, duke përfshirë njohjen e kualifikimeve dhe diskutimin e akreditimit. Kohëzgjatja e zakonshme e projektit është 2 vite.

Kush mund të marr pjesë?

Ky projekt është i hapur për grupet e institucioneve të arsimit të lartë nga BE-ja dhe vendi partner, si dhe për studentët dhe fakultetet që u përkasin këtyre institucioneve të arsimit të lartë. Për projektet e orientuara në politika (vetëm në ShBA) mund të marrin pjesë edhe organizatat e tjera, siç janë: agjencitë për akreditim, agjencitë apo organizatat arsimore, kompanitë private, grupet e industrisë dhe të biznesit, organizatat joqeveritare, institutet e hulumtimit dhe entitetet profesionale.

Vendet pjesëmarrëse janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Australia, Japonia, Zelanda e Re dhe Koreja e Jugut.

Si mund të aplikoj?

Konzorciumet e institucioneve mund të aplikojnë për financim përmes ftesave vjetore për propozime. Organizatat dhe individët duhet të kontaktojnë Agjencinë ekzekutive për arsim, çështje audiovizuale dhe kulturë të Komisionit Evropian: http://eacea.ec.europa.eu/extcoop/index_en.htm

Ku mund të marr më shumë informata?

<http://ec.europa.eu/education/industrialised-countries>



Tempus

Modernizimi i arsimit të lartë në vendet fqinje të BE-së

Për çka është i paraparë?


Tempusi ndihmon në modernizimin e arsimit të lartë në vendet partnere që janë gjeografikisht afër BE-së dhe avancojnë bashkëpunimin mes institucioneve të arsimit të lartë në BE dhe vendeve partnere.

Çka përkrah?

Tempusi përkrahë projektet e bazuara në partneritetin multilateral mes institucioneve të arsimit të lartë në BE dhe vendeve të tjera partnere, të cilat ndihmojnë në realizimin e reformave në vendet partnere në përputhje me prioritetet e tyre shtetërore dhe regjionale. Projektet e përbashkëta mund të hartojnë, modernizojnë dhe zbatojnë kurrikula, metoda të mësimdhënies apo materiale të reja, mund të rrisin kulturën e sigurimit të cilësisë, si dhe të modernizojnë menaxhimin dhe qeverisjen e institucioneve të arsimit të lartë.

Në kuadër të projektit të financuar përmes Tempusit 'Ligji për pronësinë industriale i BE-së – ndërtimi institucional' është themeluar Qendra për arsim rreth pronësisë industriale në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Shkupit, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Dymbëdhjetë trajnerë të ardhshëm janë trajnuar të ideojnë dhe të zbatojnë trajnime mbi të drejtat pronësore për shërbyesit civil, gjyqtarët, avokatët, prokurorët, agjentët e patentave dhe për konsumatorët. Po ashtu, për vijuesit e trajnimeve janë organizuar edhe kurset e gjuhëve dhe të kompjuterëve. (Njëri nga vijuesit e trajnimeve u bë kryeministër).

Masat strukturore ndihmojnë në zhvillimin dhe reformën e sistemeve të arsimit të lartë në vendet partnere, në përmirësimin e cilësisë dhe relevancës së tyre dhe në sjelljen e tyre të mëtejshme në përputhje me zhvillimet në BE.





Kush mund të marr pjesë?

Partneritetet kryesisht krijohen mes institucioneve të arsimit të lartë, por gjithashtu mund të përfshijnë bizneset, ministritë, organizatat joqeveritare dhe organizatat e tjera që punojnë në arsimin e lartë si nga BE-ja, ashtu edhe nga vendet partnere.

Programi mbulon 27 vende në Ballkanin Perëndimor, Evropën Lindore, Azinë Qendrore, Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme.

Si mund të aplikoj?

Duke iu përgjigjur ftesës për propozime, të publikuar në faqen vijuese të internetit:

http://eacea.ec.europa.eu/tempus/index_en.php

Gjithashtu ekzistojnë edhe pikat kontaktues të Tempusit në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet partnere që mund të ndihmojnë në gjetjen e partnerëve, në qartësimin e prioriteteve shtetërore apo regjionale, si dhe në shpjegimin e procedurës së aplikimit.

Informatat e tyre për kontakt mund të gjenden në:

http://eacea.ec.europa.eu/tempus/tools/contacts_en.php

Ku mund të marr më shumë informata?

http://eacea.ec.europa.eu/tempus/programme/about_tempus_en.php



Kulturë

Këmbimet studentore në fushën e arteve

Për çka është i paraparë?

Përmes këtij programi tentohet të avancohet trashëgimia e përbashkët e Evropës përmes bashkëpunimit mes organizatave aktive në fushën e kulturës.

Çka përkrah?

Kultura përkrah lëvizshmërinë e njerëzve të punësuar në sektorin e kulturës, qarkullimin ndërkombëtar të produkteve dhe veprave kulturore e artistike, si dhe dialogun ndërkulturor. Përmes qasjes fleksibile dhe ndërdisiplinore përkrahen projektet, organizatat, aktivitetet promovuese dhe hulumtimet në të gjitha degët e kulturës.

Veprimet kulturore

- Projektet shumëvjeçare dhe njëvjeçare të bashkëpunimit kulturor që bashkojnë njerëz nga mbarë Evropa, të cilët punojnë në fushën e kulturës.
- Përkthimi i të gjitha llojeve të romaneve në gjuhët e ndryshme të Evropës.
- Veprimet e ndryshme që rrisin ndjenjën e përkatësisë së njerëzve ndaj komunitetit të njëjtë, i vetëdijesojnë ata për diversitetin kulturor të Evropës dhe kontribuojnë në dialogun ndërkulturor dhe ndërkombëtar. Si shembuj mund të përmendim: Kryeqytetet evropiane të kulturës, shpërblimin e Evropës për të arriturat ndërkufitare në muzikën pop, shpërblimin e Bashkimit Evropian për letërsi, shpërblimin e Bashkimit Evropian për arkitekturën moderne dhe shpërblimin e Bashkimit Evropian për trashëgiminë kulturore.






'Dizajni i fantazisë' ka qenë një projekt 3 vjeçar në Finlandë, Belgjikë, Norvegji, Mbretëri të Bashkuar dhe Danimarkë, ku nxënësit e shkollave të moshës prej 5 deri në 17 vjeçare kanë qenë pjesëmarrësit dhe prodhuesit kryesorë. Ky projekt bashkoi dizajnesit profesionalë dhe mësimdhënësit e dizajnit për të nxitur interesimin në dizajn dhe për të hartuar materialet e trajnimit dhe të mësimdhënies. Nxënësit e shkollave kanë marrë pjesë në punëtori të organizuara nga dizajnesit profesionalë, ku ata kanë punuar në dizajnet e veta. Një juri ndërkombëtare përzgjedhi dizajnet që do të shndërroheshin në prototipe dhe i ka ekspozuar ato në një ekspozitë udhëtuese. Përmes këtij projekti u stimulua kreativiteti dhe u rritë vetëdijesimi i fëmijëve për dizajnimin e prodhimeve dhe për kulturën e materialeve. Gjithashtu, janë krijuar kontakte mes dizajnesve dhe shkollave, ndërsa mësimdhënësit kanë zhvilluar shkathtësitë e tyre në fushën e dizajnit.

Organizatat aktive në nivel evropian

Përmes programit Kultura përkrahen organizatat që kanë për qëllim realizimin e qëllimeve të interesit të përbashkët evropian në fushën e kulturës dhe që kanë dimension të vërtetë evropian. Përkrahja u jepet ambasadorëve të kulturës (p.sh. orkestrave, koreve, trupave të teatrove dhe grupeve të vallëzimit), rrjeteve dhe strukturave për përkrahjen e politikave.

Analiza, grumbullimi dhe shpërndarja e informatave, si dhe maksimalizimi i ndikimit të projekteve

Përkrahja ofrohet për analizat në fushën e bashkëpunimit kulturor të Evropës dhe të zhvillimit të politikave në fushën e kulturës.



Kush mund të marr pjesë?

Mund të marrin pjesë organizatat kulturore dhe projektet e propozuara nga organizatat kulturore (individët nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje).

Vendet me të drejtë pjesëmarrjeje janë 27 vendet e BE-së, Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Turqia, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia dhe Mali i Zi. Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina do të mund të marrin pjesë nga viti 2011, pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit. Ashtu siç është përshkruar në shtojcë, programi po ashtu është i hapur ndaj bashkëpunimit me vendet e treta që kanë nënshkruar marrëveshje specifike me BE-në dhe që kanë ratifikuar Konventën e Unesco-s për mbrojtjen dhe avancimin e diversitetit të shprehjeve kulturore.

Si mund të aplikoj?

Organizatat duhet t'i drejtohen pikave kontaktuese të programit Kultura në vendin e tyre.

Këto pika të kontaktit gjenden në:

http://ec.europa.eu/culture/annexes-culture/doc1232_en.htm

Ku mund të marr më shumë informata?

http://ec.europa.eu/culture/calls-for-proposals/call2061_en.htm

Kulturë





MEDIA



Zhvillimi i filmit dhe i produksioneve televizive të Evropës

Për çka është i paraparë?

MEDIA është program i përkrahjes i BE-së për industrinë audiovizuale të Evropës. Ky program tenton të fuqizojë sektorin audiovizual të Evropës në atë mënyrë që të pasqyrojë identitetin kulturor dhe trashëgiminë e Evropës. Përmes këtij programi përkrahet qarkullimi i punëve audiovizuale të Evropës brenda BE-së, avancohet qarkullimi i tyre jashtë vendit dhe nxitet në konkurrueshmërinë e sektorit, duke dhënë qasje në financime.

Çka përkrah?

Programi MEDIA bashkëfinancon nismat trajnuese për profesionistët e industrisë audiovizuale, zhvillimin e projekteve të produksionit (filmave, dramave televizive, dokumentarëve, filmave të animuar dhe mediave të reja), distribuimin e filmave evropian dhe avancimin e punëve audiovizuale të Evropës. Ky program përfshin veprimet për fuqizimin e strukturave të produksionit të bizneseve të vogla, ndihmon në përhapjen e kulturës së biznesit brenda sektorit, lehtëson investimet private dhe përcjellin ndryshimet që krijon digjitalizimi në të gjitha fazat të zinxhirit të produksionit dhe distribuicionit:

- Trajnimi i vazhdueshëm për producentë, distributorë, operatorë, skenaristë, regjisorë — përmes organizatave dhe kompanive evropiane për trajnime në sektorin audiovizual;
- Financimi i projekteve të caktuara, financimi për punët ndërvepruese dhe qasja e lehtësuar në financim nga institucionet financiare, duke garantuar një pjesë të koston;
- Distribuicioni i filmave të përzgjedhur evropian në kinematë e Evropës dhe për programet evropiane përmes transmetimit televiziv;
- Avancimi në Evropë dhe më gjerë i filmave evropian dhe veprave të tjera audiovizuale në panaire dhe festivale, si dhe ndihmesa për profesionistët në krijimin e qasjes në tregje.





Një numër i filmave të përkrahur së fundi nga programi MEDIA

Shiriti i bardhë nga Majkëll Heneke (Michael Haneke)

Slumdog millionaire nga Deni Bojll (Danny Boyle)

4 muaj, 3 javë dhe 2 ditë nga Kristian Mungiu (Cristian Mungiu)

L'auberge espagnole nga Sedrik Kllapish (Cédric Klapisch)

Lamtumirë Lenin! nga Wolfgang Beker (Wolfgang Becker)

La vie en rose nga Olivije Dahan (Olivier Dahan)

Marshi i pinguinëve nga Llyk Zhake (Luc Jacquet)

Persepolis nga Marjane Satrapi dhe Vinsent Perono (Vincent Paronnaud)

Falsifikuesit nga Stefan Ruzovicki (Stefan Ruzowitzky)

Jetët e të tjerëve nga Florian Henckell fon Donersmark (Florian Henckel von Donnersmarck)

Era që lëkund elbin nga Ken Loaç (Ken Loach)

Përqaqimet e thyera nga Pedro Almodóvar



Kush mund të marr pjesë?

Profesionistët e mediave dhe të çështjeve audiovizuale, kompanitë e produksionit, distributorët, agjentët e shitjes, ekspozuesit, organizatat për trajnime, konzorciumet panevropiane që ofrojnë shkollim fillestar në sektorin audiovizual (shkollat e filmit apo të biznesit) dhe kompanitë e organizatat e tjera të lidhura me industrinë audiovizuale.


Vendet me të drejtë pjesëmarrjeje janë 27 shtetet e BE-së, Islanda, Lihtenshajni, Norvegjia, Kroacia dhe Zvicra.

Si mund të aplikojë?

Përmes ftesave për propozime me afate specifike.

Ku mund të marr më shumë informata?

<http://ec.europa.eu/media>



Marie Curie Actions



Mundësitë për karrierë në fushën e hulumtimeve

Për çka janë të parapara?

Programi Marie Curie Actions është i paraparë të nxitë zhvillimin e karrierave të hulumtuesve në të gjitha fushat e shkencës dhe të humanistikës. Ky program u ofron hulumtuesve mundësitë t'i rrisin dhe diversifikojnë shkathtësitë e tyre, t'u bashkohen ekipeve të krijuara hulumtuese dhe të përmirësojnë perspektivën e tyre të karrierës. Ky program po ashtu fuqizon bartjen e njohurive në programet e strukturuar të trajnimeve dhe avancojnë lëvizshmërinë ndërkombëtare të hulumtuesve.


Çka përkrah?

Rrjetet për trajnimet fillestare

Në kuadër të rrjetit të instituteve për hulumtime publike dhe partnerëve komercial (duke përfshirë NMV-të), hulumtuesit e rinj trajnohen për projekte individuale dhe të personalizuar të hulumtimit, të plotësuar nga modulet e strukturuar të trajnimit në shkathtësi dhe kompetenca të tjera relevante—duke përfshirë menaxhimin dhe financimin e projekteve dhe programeve të hulumtimit, të drejtat e pronësisë intelektuale, mënyrat e shfrytëzimit të rezultateve të hulumtimeve, ndërmarrësinë, aspektet etike dhe komunikimin.

Bursat ndëroevropiane për zhvillimin e karrierës

Këto bursa ndihmojnë në fitimin e shkathtësive apo përvojave të reja në sektorë të tjerë për hulumtuesit me përvojë, përmes financimeve për trajnime të avancuara dhe zhvillim të karrierës, duke përfshirë shkathtësitë në fushën e hulumtimeve shkencore, siç është ndihmesa me teknika a instrumente të reja apo në përgatitjen e propozimeve për kërkimin e financimeve ose për aplikime për patentë, si dhe për menaxhimin e projekteve hulumtuese. Grantet duhet të përfshijnë lëvizshmërinë brenda Evropës.





Grantet evropiane për reintegrim

Përmes këtyre granteve jepen fonde për projekte të hulumtimit (paga, udhëtime, material shpenzues, aplikacione për patentë, etj) me qëllim të ofrimit të ndihmesës në re(integrimin) profesional në Evropë, si dhe të përkrahjes së punësimit afatgjatë të hulumtuesve që kanë përfituar nga trajnimet në kuadër të programit Marie Curie Action.

Grantet ndërkombëtare për reintegrim

Përmes këtyre granteve ofrohen fonde për projekte hulumtuese (paga, udhëtime, material shpenzues, aplikacione për patentë, etj) me qëllim të ndihmesës në re(integrimin) profesional në Evropë të hulumtuesve Evropianë që kanë kryer hulumtime jashtë Evropës.

Bashkëfinancimi i programeve regjionale, shtetërore dhe ndërkombëtare

Përmes këtyre veprimeve bashkëfinancohen programet regjionale, shtetërore dhe ndërkombëtare për trajnime në fushën e hulumtimeve dhe për zhvillim të karrierës. Programet e bashkëfinancuara duhet të jenë të bursave të nivelit pasdoktorues apo për hulumtuesit me më shumë përvojë, dhe duhet të përfshijnë lëvizshmëri ndërkombëtare.

Bursat ndërkombëtare për hulumtuesit që dalin jashtë BE-së

Përmes këtyre bursave ofrohet financimi (paga, kostot e ndërlidhura me hulumtime) për trajnime të avancuara të hulumtuesve me përvojë evropiane që realizojnë hulumtime të nivelit të lartë në universitet, qendër të hulumtimit apo kompani në vendet jashtë BE-së.

Bursat ndërkombëtare për hulumtuesit që vinë në Evropë

Përmes këtyre bursave ofrohet financimi (paga, kostot e ndërlidhura me hulumtime) për hulumtuesit nga vendet jashtë Evropës që punojnë në projekte në një institucion nikoqir në Evropë.



Rezolucioni i lartë dhe qartësia kristalore janë ato që i kërkojnë konsumatorët tek ekranet moderne me kristal të lëngshëm, siç janë televizorët. 'Heterolitics' është emërtimi i projektit hulumtues për krijimin e brezit të ri të materialeve të kristalineve të lëngshme që mund të ndihmojnë në avancimin e teknologjisë së tanishme tek diodat organike që emetojnë dritë. Përmes bursës për hulumtuesit nga vendet jashtë Evropës, vizioni i shkencëtarit të ri nga Rusia, Valeri Kozhenikov, nga Universiteti shtetëror teknik i Uralit në Jekatarinburg, dhe mentori i tij në Mbretërinë e Bashkuar, profesori Dankan Brus, nga Universiteti i Jorkut, tani është duke hapur sytë tonë për standardet edhe më të larta të cilësisë vizuale. Hulumtuesit kanë aplikuar për patentë për njërin prej materialeve, të zhvilluar në bursës Marie Curie dhe një kompanie japoneze që punon në këtë treg prej shumëmiliardë eurosh. Hulumtuesi rus së bashku me profesorin Brus kanë krijuar një marrëdhënie të përhershme. 'Në aspektin e bashkëpunimit, ne kemi arritur 100% sukses', thotë Dr. Kozhenikov.

Skema e këmbimit e hulumtuesve ndërkombëtarë

Kjo skemë ofron financime (koston e banimit dhe të udhëtimit) për punonjësit e universiteteve, qendrat hulumtuese dhe organizatat e ndërlidhura të sektorit publik në vendet partnere jashtë BE-së (vendet që kanë nënshkruar marrëveshjen e BE-së për shkencë dhe teknologji ose vendet fqinje) në kuadër të programit të bashkërenduar të këmbimit mes organizatave hulumtuese evropiane dhe joevropiane me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit afatgjatë.


Partneritetet mes industrisë dhe akademisë

Përmes këtyre partneriteteve ofrohen financimet për lëvizshmërinë ndërsektorale: këmbimi i punonjësve mes instituteve publike të hulumtimit dhe partnerëve komercialë (duke përfshirë NVM-të) që punojnë së bashku në projektet e përbashkëta të hulumtimit dhe rekrutimi i hulumtuesve me përvojë nga jashtë partneritetit.

Nata e hulumtuesve

Ky program parasheh financimin e ngjarjeve njënatëshe që u ofrojnë publikut aktivitete edukative dhe i mundësojnë përmirësimin e njohurive për hulumtimet.

Marie Curie Actions



Kush mund të marr pjesë?

Mund të marrin pjesë hulumtuesit në të gjitha fazat e karrierës së tyre, universitetet, qendrat hulumtuese, organet përgjegjëse për financimin e trajnimeve hulumtuese dhe kompanitë.

Vendet me të drejtë pjesëmarrjeje janë 27 vendet e BE-së dhe vendet e ndërlidhura me programin e shtatë kornizave të BE-së. Po ashtu, hulumtuesit dhe organizatat nga vendet jashtë BE-së kanë të drejtë pjesëmarrjeje në disa aktivitete.

Si mund të aplikoj?

Përmes ftesës për propozime dhe përmes aplikacioneve individuale në konkurse të hapura dhe të shqyrtuara nga profesionistët:
<http://cordis.europa.eu/fp7/dc/index.cfm>

Mund të gjeni të gjitha informatat e nevojshme për të vendosur kur dhe si të paraqitni aplikacionin në:
<http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/how.htm>

Ekzistojnë pikat shtetërore të kontaktit në shtetet anëtare dhe në vendet e ndërlidhura që japin këshilla dhe ndihmesë individuale:
http://cordis.europa.eu/fp7/ncp_en.html

Ku mund të marrë më shumë informata?

<http://ec.europa.eu/mariecurieactions>



Shtojcat

Vendet pjesëmarrëse

Të gjitha shtetet anëtare të BE-së, si dhe Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia kanë të drejtë pjesëmarrjeje në të gjitha programet. Kjo tabelë tregon në formë të përgjithshme, se cilat vende të tjera kanë mundësi të marrin pjesë në secilin prej programeve. Për hollësi të tjera, shihni informatat për secilin program.

Rinia në veprim	Turqia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova (*), Mali i Zi, Serbia, Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia, Rusia, Ukraina, Algjeria, Egjipti, Izraeli, Jordani, Libani, Maroku, Autoriteti palestinez i Bregut Perëndimor dhe i Rripit të Gazës, Siria, Tunizia
Comenius	Turqia, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (**)
Erasmus	Turqia, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (**)
Leonardo Da Vinci	Turqia, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (**)
Grundtvig	Turqia, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (**)
Programi ndprsektoral	Turqia, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (**)
Zhan Mone	62 vende
Erasmus Mundus	Të gjitha vendet e botës
Bashkëpunimi me vendet e industrializuara	Shtetet e bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Australia, Zelanda e Re, Japonia, Koreja e Jugut
Tempus	27 shtete të Ballkanit Perëndimor, Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore, Afrikës së Veriut dhe Lindjes së Mesme
Kultura	Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia, Turqia, si dhe ato vende që synohen për pjesëmarrje në vitin e caktuar (Meksika për vitin 2011 dhe Afrika e Jugut për vitin 2012)
MEDIA	Kroacia dhe Zvicra
Marie Curie Actions	Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Izraeli, Mali i Zi, Serbia, Zvicra, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Turqia (për disa aktivitete, organizatat dhe individët në vendet e treta po ashtu mund të marrin pjesë) (***)

(*) Sipas Rezolutës 1244/1999 të KSKB-së.

(**) Në fazën përgatitore mund të marrin pjesë Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë.

(***) Lista e vendeve të treta me të drejtë pjesëmarrjeje në http://cordis.europa.eu/fp7/who_en.html#countries



Kontaktet

Komisioni Evropian

Drejtoria e përgjithshme për arsim dhe kulturë 1049 Bruksel

BELGJIKË

Tel. +32 229-91111

Fax +32 229-57633

http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/index_en.htm

E-mail: eac-info@ec.europa.eu

Agjencia ekzekutive për arsim, çështje audiovizuale dhe kulturë

BOUR 01/01

Avenue du Bourget/Bourgetlaan 1

1140 Bruksel

Belgjikë

Tel. +32 229-75615

Fax +32 229-21330

<http://eacea.ec.europa.eu/index.htm>

E-mail: eacea-info@ec.europa.eu



Faqet e internetit

Cedefop — Qendra evropiane për zhvillimin e trajnimeve profesionale:
<http://www.cedefop.europa.eu>

Shërbimi udhëzues për qytetarë:
<http://ec.europa.eu/citizensrights>

CRELL — Qendra për Hulumtime të të Mësuarit Gjatë tërë jetës:
<http://crell.jrc.ec.europa.eu>

EIT — Instituti Evropian për Inovacion dhe Teknologji:
<http://eit.europa.eu>

ETF — Fondacioni Evropian për Trajnime:
<http://www.etf.europa.eu>

EURES — Portali Evropian për Lëvizshmërinë e Punës:
<http://ec.europa.eu/eures>

Europass:
<http://europass.cedefop.europa.eu>

Eurydice — Informata për Sistemet e Arsimit dhe Politikat në Evropë:
http://eacea.ec.europa.eu/education/eurydice/index_en.php

EVE — Rezultatet e projekteve në Arsim, Trajnime, Kulturë, Rini dhe Qytetari:
http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/eve/index_en.htm

Ploteus — Portali për Mundësitë e Shkollimit në tërë Hapësirën Evropiane:
<http://ec.europa.eu/ploteus>

Youth on the Move — EU mobility opportunities, Youth on the Move campaign:
http://ec.europa.eu/youth_on_the_move



Pyetje për Evropën? Kontaktoni me Europe Direct:

http://ec.europa.eu/europedirect/index_en.htm

Studimi në Evropë dhe gjetja e universitetit që më së shumti ju konvenon

<http://ec.europa.eu/education/study-in-europe/>

Portali i rinisë: <http://europa.eu/youth/index.cfm>

Botimet

Libraria e BE-së:

<http://bookshop.europa.eu>

Botimet e Drejtorisë së përgjithshme për arsim e kulturë:

http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/publ/eac_en.html

Shtojcat

'Çka
ka për
mua?'

55



Pika juaj kontaktuese:





© Bashkimi Evropian, 2012
Riprodhimi është i autorizuar me kusht të identifikimit të burimit.
Zyra e botimeve e Bashkimit Evropian, 2010
2012 — 60 fq. — 14,8 x 21 cm
ISBN 978-92-9238-049-6
doi 10.2671/14760


Si mund t'i merni botimet e BE-së

Botimet falas:

- > përmes librarisë së be-së (<http://bookshop.europa.eu>);
 - > në përfaqësitë apo delegacionet e komisionit evropian.
- mund të merni informatat e tyre për kontakt në internet (<http://ec.europa.eu>) ose përmes dërgimit të faksit në +352 2929-42758.

Botimet në shitje:

- > përmes librarisë së be-së (<http://bookshop.europa.eu>). abonimet në shitje (p.sh. vëllimet vjetore të gazetës zyrtare të bashkimit evropian dhe raportet për lëndët para gjykatës së drejtësisë të bashkimit evropian);
- > përmes njërit prej agentëve të shitjes të zyrës së botimeve të bashkimit evropian (http://publications.europa.eu/others/agents/index_en.htm).



Publications Office

ISBN 978-92-9238-049-6



9 789292 1380496